

VENDIM
Nr. 115, datë 14.5.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “UDHËZUESIT PËR KËRKESAT ORGANIZATIVE, ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË LIDHJE ME SHKËMBIMIN E TË DHËNAVE” (KORP)

Në mbështetje të neneve 16; 7; 56, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ndryshuar; të nenit 40, pika 6, të rregullores së Komisionit të BE-së 2017/1485, “Mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike (SO GL)”;

të nenit 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 14.5.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga drejtoritë teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Udhëzuesit për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP),

konstatoi se:

- Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a. është anëtar me të drejta të plota i rrjetit evropian të operatorëve të sistemit të transmetimit për energjinë (ENTSO-E).

- OST sh.a., me shkresën nr. 3103 prot., datë 27.4.2018, ka përcjellë në ERE për miratim propozimin e të gjithë OST-ve mbi “Udhëzuesin për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP).

- Ky propozim vjen në zbatim të neneve 7, 56 dhe 63, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 117, pika 5, të Kodit të Transmetimit të miratuar me vendimin e ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, sipas të cilit: “OST sh.a. do të zbatojë urdhrin e ENTSO-E (*European Network of Transmission System Operators for Electricity*/rrjeti evropian i operatorëve të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike), të miratuar nga të gjithë OST-të e zonës sinkrone, në lidhje me kërkesat kryesore, organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP).

- Interpretimi i KORP-së do të bëhet në përputhje me Kodin e Transmetimit, si dhe dokumentet e tjera të cilave iu referohet dokumenti. KORP-ja është propozim i të gjitha OST-ve të ENTSO-E për kërkesat themelore organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave, draftuar në përputhje me nenin 40, pika 6, të rregullores së Komisionit të BE-së 2017/1485, “Mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike SO GL” (*Security of Operation Guideline, or Commission Regulation (EU) 2017/1485 of 2 August 2017 establishing a guideline on electricity transmission system operation*/rregullorja e Komisionit të (BE) 2017/1485 ose udhëzuesi mbi sigurinë operationale).

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Udhëzuesit për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave (KORP).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti